



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 284/9 prot

Datë 21.02.2024

V E N D I M
Nr. 200/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

| | |
|------------------|------------|
| Fiorent Zguro | Nënkryetar |
| Kreshnik Ternova | Anëtar |
| Anila Malaj | Anëtar |

Në mbledhjen e datës 21.02.2024 me

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “*I-Fire*” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-92936-01.09.2024 me objekt: “Shërbim për rimbushjen dhe kolaudimin e pajisjeve kundër zjarrit”, me fond limit 7,497,514.00 Lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 22.01.2024 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike Tiranë me adresë Rruga “5 Maji”, God.17, Tiranë.

Ankimues: Operatori ekonomik “Victoria-AL” SHPK me NIPT K81531041T dhe adresë Rruga “Muhamet Gjollësja”, Pallati 58, Shkalla 1, Ap 3, Tiranë.

Subjekte të Interesuar: Operatori ekonomik “*I-Fire*” SHPK me NIPT L71921002H, adresë Rruga “Kavajës”, Pallati nr.4, Dyqani nr.9, Pranë Shkollës Teknologjike, ZK 8260, nr. Pasurie 1/301, Tiranë.

Baza Ligjore: Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë

19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, dhe nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 05.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 10.01.2024, është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-92936-01-09-2024, me objekt: “Shërbim për rimbushjen dhe kolaudimin e pajisjeve kundër zjarrit”, me fond limit 7,497,514.00 Lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 22.01.2024, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike Tiranë.

II.2. Në datën 24.01.2024, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

- | | |
|--|-----------------------------|
| 1. “i-FIRE” SHPK | 5,638,700 lekë, kualifikuar |
| 2. “Mbrojtja dhe Shpëtimi nga Zjarri” SHPK | 6 188 900 lekë, kualifikuar |
| 3. “VICTORIA-AL” SHPK | 7 026 920 lekë, kualifikuar |

II.3. Në datën 01.02.2024, autoriteti kontraktor ka kryer Publikimin e Njoftimit të Fituesit Paraparak në SPE.

II.4. Në datën 06.02.2024, pranë Komisionit të Prokurimit Publik nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2023/3789, si dhe nr. protokollit 284/2024, datë 06.02.2024, i operatorit ekonomik “Victoria-AL” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit.

Nga shqyrtimi paraparak i ankesës së sipërcituar, u konstatua, se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “i-FIRE” SHPK.

II.5. Në përputhje me nenin 112, “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. Prot., 284/2 date 07.02.2024, lidhur me kriteret kualifikuese për të cilat pretendohet se nuk përmbushen nga ana e operatorit ekonomik “i-FIRE” SHPK.

II.6. Në datën 15.02.2024, është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 284/4 prot., shkresa e autoritetit kontraktor nr. 623/4 prot., datë 13.02.2024, me lëndë: “Kthim - përgjigje ankesës së operatorit ekonomik”, drejtuar operatorit ekonomik ankimues “Victoria-AL” SHPK dhe për dijeni Komisionit të Prokurimit Publik. Referuar aktit të trajtimit të ankesës rezultoi, se ankesa e operatorit ekonomik “Victoria-AL” SHPK, është refuzuar nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës.

II.7. Në datën 16.02.2024, është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 284/5, shkresa e operatorit ekonomik “Victoria-AL” SHPK, datë 15.02.2024, me lëndë “Argumentim shtesë për ankesën me datë aplikimi online: 2024-02-06 10:32:49 Nr aplikimi online: A/2024/3789, Numri i protokollit:284/2024, data e protokollit: 2024-02-06, Tipi i ankesës: Vlerësim”.

II.8. Në datën 21.02.2024, është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 284/6, shkresa e operatorit ekonomik “Victoria-AL” SHPK, datë 20.01.2024, me lëndë “Informacion dhe Argumentim shtesë për ankesën me datë aplikimi online: 2024.02.06,10:32:49, Nr.

aplikimi online: A/2024/3789, Numri i protokollit:284/2024, data e protokollit: 2024-02-06, Tipi i ankesës: V- Vlerësim”.

II.7. Në datën 13.02.2024, protokolluar pranë KPP-së me nr.284/3 prot., operatori ekonomik “i-FIRE” SHPK, si operator ekonomik i interesuar në këtë procedurë prokurimi, ka dorëzuar argumente në përputhje me nenin 113 të LPP-së.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Në lidhje me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Victoria-Al” SHPK për skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “i-Fire” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik para shqyrtimit në themel të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, konstaton, se ky i fundit nuk legjitimohet për të paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

II.1.1. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datën 24.01.2024, ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

| | |
|--|-----------------------------|
| 4. “i-FIRE” SHPK | 5,638,700 lekë, kualifikuar |
| 5. “Mbrojtja dhe Shpëtimi nga Zjarri” SHPK | 6 188 900 lekë, kualifikuar |
| 6. “VICTORIA-AL” SHPK | 7 026 920 lekë, kualifikuar |

II.1.2. Në datën 01.02.2024, autoriteti kontraktor ka kryer Publikimin e Njoftimit të Fituesit Paraprak në SPE.

III.1.3. Neni 24, pika 1, “Komisioni i prokurimit Publik” i Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: “Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit dhe kryen çdo detyrë tjetër që i ngarkohet me këtë ligj dhe akte të tjera ligjore brenda fushës së kompetencave të tij.”.

III.1.4. Në nenin 110, pikat 2, 7 dhe 8 “Afatet për ankimim” të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: “2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët

ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimi të anulimit.

Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.

7. Në rast se operatori ekonomik nuk paraqet ankesën brenda afateve të parashikuara në këtë nen, atëherë nuk ka mundësi të ushtrojë më të drejtën e ankimit pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

8. Të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare nuk pengojnë fillimin dhe kohëzgjatjen e afateve. Kur dita e fundit e një afati bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj. Ankesa quhet e pranuar në ditën e depozitimit të saj pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.”.

III.1.5. Në nenin 111, pika 1, të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: *“1. Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik. Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.”.*

III.1.6. Në nenin 94 pika 1 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet:

1. Çdo operator ekonomik, i cili ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi sipas LPP, dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga veprimet ose mosveprimet e autoritetit/entit kontraktor, për të cilat pretendon se janë në kundërshtim me ligjin, ka të drejtë të ankohet pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

III.1.7. Në rastin konkret, nga shqyrtimi i ankesës së operatorit ekonomik ankimues, informacionit të autoritetit kontraktor, si dhe verifikimi në Sistemin e Prokurimit Elektronik, rezulton, se autoriteti kontraktor në datën 24.04.2024, ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, ku operatori ekonomik “Victoria-AL” SHPK rezulton i kualifikuar. Gjithashtu, në datën 01.02.2024, është publikuar njoftimi i fituesit në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, prej së cilit rezulton fitues operatori ekonomik “i-Fire” SHPK. Në datën 06.02.2024, operatori ekonomik “Victoria-AL” SHPK ka paraqitur ankesë nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, njëkohësisht pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “I-Fire” SHPK në procedurën e prokurimit objekt-ankimi, por nuk ka ngritur asnjë pretendim për sa i përket kualifikimit të ofertës ekonomike të operatorit ekonomik “Mbrojtja dhe Shpëtimi nga Zjarri” SHPK.

Në interpretim literal, sistematik dhe teologjik, me synim vendosjen në pah të ratio legis, mbështetur edhe në parimin e së drejtës se ratio legis est anima legis, (qëllimi i ligjit është edhe shpirti i ligjit), interesi i ligjshëm i operatorëve për të paraqitur ankim pranë autoritetit kontraktor si edhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duhet të jetë dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i marrë nga autoriteti kontraktor në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik. Neni 94, pika 1 e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, kërkon

shprehimisht që ankimuesi, jo vetëm të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor. Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson, se operatori ekonomik ankimues është njoftuar në përputhje me parashikimet e ligjit për prokurimin publik në lidhje me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave pranë autoritetit kontraktor, nga ku rezulton që të tre operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë “i-FIRE” SHPK, “Mbrojtja dhe Shpëtimi nga Zjarri” SHPK, “VICTORIA-AL” SHPK janë kualifikuar. Brenda afateve të parashikuara të ankimit në nenin 110 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, ankimuesi ka parashtruar pretendime vetëm mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “i-Fire” SHPK, duke mos paraqitur pretendime për kualifikimin e operatorit ekonomik “Mbrojtja dhe Shpëtimi nga Zjarri” SHPK, i cili është i kualifikuar dhe i renditur me ofertë më të ulët ekonomike se ajo e operatorit ekonomik ankimues.

Referuar ligjit dhe rregullave të prokurimit publik, duhet të plotësohen dy kushte kumulative: (legjitimitimi *locus standi*), interesi i ligjshëm për të marrë një kontratë, ose dëmtimi apo rreziku për t’u dëmtuar nga një shkelje e pretenduar. Në rastin kur operatori ekonomik ankimues ka paraqitur pretendime vetëm për kualifikimin e operatorit ekonomik “i-Fire” SHPK, duke mos paraqitur pretendime për kualifikimin e operatorit ekonomik “Mbrojtja dhe Shpëtimi nga Zjarri” SHPK, atëherë ai qartësisht nuk mund ta fitojë kontratën.

Komisioni i Prokurimit Publik thekson, se LPP parashikon në mënyrë eksplicite, se për çdo vendimmarrje të autoritetit kontraktor, operatorët ekonomikë që rrezikojnë të dëmtohen nga ky vendim duhet të ushtrojnë të drejtën e tyre të ankimit njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik brenda afateve të parashikuara në LPP, duke respektuar të gjitha elementet formale sipas dispozitave ligjore. Operatori ekonomik ankimues “Victoria-AL” SHPK, ka paraqitur pretendime vetëm mbi vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “i-FIRE” SHPK dhe nuk ka kundërshtuar kualifikimin e operatorit ekonomik “Mbrojtja nga zjarri” SHPK, i cili është i kualifikuar dhe i renditur me ofertë më të ulët ekonomike se ajo e operatorit ekonomik ankimues.

Referuar përcaktimeve ligjore si më sipër cituar, kërkohet që ankimuesi, jo vetëm që duhet të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor.

Një ankimues do të konsiderohet i dëmtuar apo disavantazhuar, kur ai ka vuajtur apo rrezikon dukshëm të vuajë personalisht një pasojë të ardhur drejtpërdrejtë nga veprimi i autoritetit kontraktor dhe kjo mund të kurohet (rregullohet) përmes ankimit pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik. Gjithashtu, akti i pretenduar duhet të ketë ndodhur në hapësirën e të drejtave të tij ligjore në kuadrin e një procedure prokurimi publik.

III.1.8. I vetmi interes i ligjshëm, që mund të ketë një operator ekonomik i dëmtuar nga një vendim i një autoriteti kontraktor, i dhënë në kuadrin e një procedure prokurimi është, që përmes ankimit ai të fitojë kontratën. Në ato raste kur, operatori ekonomik ankimues ka kundërshtuar vetëm kualifikimin e operatorit ekonomik “i-FIRE” SHPK, duke mos

kundërshtuar kualifikimin e operatorit ekonomik ankimes “Mbrotja dhe shpëtimi nga zjarri” SHPK, duke humbur kështu të drejtën për t’u ankimuar brenda afateve ligjore për kualifikimin e operatorit ekonomik “Mbrotja dhe shpëtimi nga zjarri” SHPK, atëherë ai qartësisht nuk mund ta fitojë kontratën. Edhe në hipotezën, se pretendimet e parashtruara në ankimin e tij në lidhje me operatorët ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit “i-Fire” SHPK, do të pranohen nga KPP, ankimesi sërish nuk do të ishte fitues i kontratës, për sa kohë nuk ka kundërshtuar kualifikimin e operatorit ekonomik “Mbrotja dhe Shpëtimi nga zjarri” SHPK, cili është i kualifikuar dhe i renditur me ofertë më të ulët ekonomike se ajo e operatorit ekonomik ankimes. Pra, në kuptim të ligjit, interesi i tij i ligjshëm, i drejtpërdrejtë e real nuk ka se si të dëmtohet nga suksesi apo dështimi i operatorit ekonomik “i-Fire” SHPK në atë procedurë prokurimi.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se për sa kohë që operatori ekonomik ankimes “Victoria-AL” ShPK në ankesën pranë KPP, ka ngritur pretendime vetëm mbi kualifikimin e ofertës ekonomike të operatorit ekonomik “i-Fire” SHPK, e në asnjë rast nuk ka kërkuar skualifikimin e operatorit ekonomik “Mbrotja dhe Shpëtimi nga zjarri” ShPK, i cili rezultoi i kualifikuar dhe me ofertë më të ulët ekonomike se ajo e operatorit ekonomik ankimes, trajtimi i pretendimeve të ankimesit në lidhje me kualifikimin e ofertës ekonomike të operatorit ekonomik “i-Fire” SHPK, nuk ka ndikim mbi fatin e çështjes, pasi bazuar në legjislacionin në fuqi për prokurimin publik, interesi i ligjshëm i drejtpërdrejtë i ankimesit, nuk ka sesi të dëmtohet, pasi edhe në hipotezën që këto pretendime do të pranoheshin, ai sërish nuk do të mund të shpallej fitues i kontratës objekt - prokurimi, duke qenë se në renditjen përfundimtare, para tij qëndron një tjetër operator ekonomik i kualifikuar me ofertë më të ulët ekonomike.

Kështu që rrjedhimisht, operatori ekonomik ankimes nuk legjitimohet për të paraqitur ankesë për operatorin ekonomik “I-Fire” SHPK, për sa kohë nuk ka paraqitur ankesë për operatorin ekonomik “Mbrotja dhe Shpëtimi nga zjarri” ShPK, i cili rezultoi i kualifikuar dhe me ofertë më të ulët ekonomike, se e operatorit ekonomik ankimes, duke mos gëzuar asnjë interes të ligjshëm në këtë procedurë prokurimi, në kuptim të nenit 94, pika 1, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimes nuk merren në shqyrtim.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik

gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Victoria-AL” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-92936-01-09-2024 me objekt: “Shërbim për rimbushjen dhe kolaudimin e pajisjeve kundër zjarrit”, me fond limit 7,497,514.00 Lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 22.01.2024 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike Tiranë.
 2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit, sipas legjislacionit të prokurimit publik.
 3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit. të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Victoria-AL” SHPK.
 4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiorent Zguro

